

VENDIM
Nr.61, datë 4.6.2008

FILLIMI I PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHITJES
ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19. 3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” pika 4.13, germa “a”, pika 2, dhe neneve 18, pika 1, germa “b”, dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.6.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. me nr.DEK /IZ 3061 prot, datë 26.5.2008 për përcaktimin e tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike, si dhe propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi këtë kërkesë:

Konstaton se:

- Ligji i sektorit të energjisë elektrike përcakton ERE-n si autoritetin e vetëm për përcaktimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike.

- Modeli i tregut të energjisë elektrike i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, parashikon përfshirjen në tregun e rregulluar të marrëdhënieve ndërmjet furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë.

- KESH sh.a. ka aplikuar në ERE për përcaktimin e tarifave të shitjes me shumicë të energjisë elektrike për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008, me cilësinë e shoqërisë, njësi e të cilës, në bazë të modelit të tregut, pika 2, paragrafi 9, është furnizuesi publik me shumicë.

- ERE me vendimet nr.18, 20 dhe 21, datë 14.2.2008 ka përcaktuar tarifat e prodhimit, shërbimit të shpërndarjes dhe çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, në kontekst të të cilëve do të përcaktohet çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi publik me shumicë te furnizuesi publik me pakicë.

Për sa konstatoi më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuesit publik me shumicë te furnizuesi publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ta njoftuar KESH sh.a.-në, mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta